

A DESHIRONI TË NDIHMONI NJË FËMIJË QE KA HUMBUR KUJDESIN PRINDËROR?

Nëse po, ju mund të bëheni familje strehuese dhe të strehoni një fëmijë në familjen tuaj përkohësisht derisa ky fëmijë të jetë në gjendje të kthehet prap tek prindërit, familja e vet apo të vendoset në adoptim.

SI MUND TË BËHENI FAMILJE STREHUESE?

Për t'u bërë familje strehuese ju do duhet të shkoni në Qendren për Punë Sociale në komunën tuaj, për të marr me shume informata rreth kushteve të cilat duhet të i plotësoni për të u bërë familje strehuese. Disa prej kushteve themelore që do duhet të plotësoni janë:

- Të jeni mbi moshën 25 vjeqare dhe të keni zotësi veprimi.
- Të keni shëndet të mirë psiko-fizik.
- Të keni të kryer së paku arsimimin e mesëm shkollor.
- Të keni pelqëimin e të gjithë anëtarëve të familjes tuaj për të ofruar strehim familjar.
- Të dëshmoni se keni vendbanim të mjaftueshme për të marr fëmijë në përkujdesje.
- Të mos jeni të ndjekur penalisht.

CILËT FËMIJË VENDOSIN NË STREHIM FAMILJAR?

Në strehim familjar vendosen përkohësisht fëmijët pa kujdes prindëror sic janë : foshnjat e braktisura menjëherë pas lindjes, fëmijë më aftësi të kufizuara, fëmijë të keqtrajtuar apo të lenë pas dorë nga prindërit apo kujdestaret e tyre, fëmijë të prindërve që iu është marr e drejta prindërore, fëmijë prindërit e të cilëve janë të paafhtë të kujdesen për fëmijët e tyre për një kohë të caktuar.

PËRKRAHJE PËR JU

Nesë ju do përzgjedheni nga Qendra për Punë Sociale (QPS) si familje strehuese atëherë ju do të përkraheni nga zyrtarët e QPS cilët do ju ndihmojnë në përkujdesjen e fëmijës derisa fëmija do qendroj në familjen tuaj, duke ju vizituar rregullisht dhe ofruar këshilla, trajnime dhe mbështetje të nevojshme.

Për t'u lehtësuar kujdesin ndaj fëmijës ju do merrni një mbështetje financiare mujore për të mbuluar shpenzimet dhe nevojat e fëmijës. Poashtu ju do të mbështeteni vazhdimisht edhe nga Organizatat që ofrojnë shërbime psiko-sociale për të siguruar mirëqenien tuaj si familje strehuese dhe të fëmijëve që vendosen në strehim familjar tek ju.

*Për me shume informata se si mund te beheni familje strehuese ju lutem vizitoni Qendren per Pune Sociale ne komunën tuaj ose kontaktoni kete numer telefoni **038 613 888** prej ores **9.00- 16.00** cdo dite pune.*




REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E DREJTËSISË



HAPË DERËN ÇELE ZEMRËN

Bëhu Familje Strehuese



Përkrahur nga UNICEF në Kosovë në partneritet me

